



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

**Shkup, 29 maj 2013**

**Hapje e njw evenimenti:  
“Forcimi i Sistemit pwr sigurinw e gjakut”**

**Qendra Informative e BE-sw**

Fjalim nga  
Ambasadori Aivo Orav  
Shef i Delegacionit tw BE-sw

**I nderuari Ministwr Todorov,**

**I nderuari z. Reesink**

**Zonja dhe zotwrinj,**

Është kënaqësi për mua t'ju mirëpres sot në Qendrën Informative të BE-së në hapjen zyrtare të projektit të **financuar nga BE: Forcimi i Sistemit të Sigurisë Gjakut.**

Për sistemin shëndetësor të vendit, ky projekt përfaqëson një hap shtesë drejt përafrimit të politikave, standardeve dhe qëllimeve të BE-së. Para së gjithash ka të bëjë me shëndetin, ka të bëjë me të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e qenieve njerëzore; ka të bëjë me të drejtën e njerëzve për të pasur qasje në sisteme cilësore dhe efikas shëndetësore. Të gjitha këto elemente janë të rëndësishme për zhvillimin e vendit, por edhe në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Gjaku dhe komponentët e gjakut janë pjesë "jetike" e shëndetit të njeriut, elemente të domosdoshme për vetë jetën tonë, të nevojshme në urgjencat mjekësore, procedurat rutinore kirurgjike por edhe në terapi të ndryshme. Përdorimi i këtyre produkteve kërkon që, cilësia, siguria dhe efikasiteti i tyre të

jenw të siguruara, në mënyrë që, për shembull, të parandalojnw ngjitjen e sëmundjeve.

Kemi nderin të pranojmë se vendi tashmë ka arritur progres të dukshwm në këtë fushë me kompletimin e ristrukturimit të sistemit pwr Transfuzion të Gjakut, me të cilin objektet e transfuzionit të gjakut tani janë integruar në një institucion nacional tw gjakut - Instituti Nacional për Mjekwsi Transfuzioni - një institucion ombrellë që përfshin 3 qendra rajonale dhe 18 njësi spitalore.

Qëllimi i përgjithshëm i ndihmës së BE për këtë sektor është të mbështesë këtë progres dhe të përmirësojw ofrimin e kujdesit shëndetësor cilësor, efikas dhe të vazhdueshëm, i cili wshtw nw gjendje të furnizojw gjak dhe komponente tw gjakut të siguritë, gjithashtu për të ndihmuar në zvogwlimin e rreziqeve nga sëmundjet ngjitëse.

Më konkretisht, projekti do të sigurojë shtrirje tw duhur tw legjislacionit nacional në fushën e sigurisë së gjakut, tw harmonizuar me Acquis të BE-së, si dhe zbatimin korrekt të saj. Nga ana tjetër, projekti do të ndihmojë në forcimin e kapaciteteve të ekspertwve shëndetësorë që punojnë në këtë fushë, me qëllim të krijimit të kushteve për sigurimin e

furnizimeve adekuate dhe me kohw të gjakut të sigurt për të gjithë pacientët në nevojë.

Më vonë BE-ja do të sigurojë mbështetje plotwsuese për sektorin, me furnizimin e pajisjeve tw teknologjive tw informimit dhe ato qw kanw tw bwjnw me gjakun, nw qendrat e ndryshme të transfuzionit. Nw fillimin e vet, ky projekt do të plotësojë sistemin që ne po prezantojmw sot dhe do të forcojw më tej sistemin e sigurisë të gjakut në vend.

Prandaj, është një kënaqësi e madhe qw shohim fillimin e këtij projekti dhe unw me padurim pres të shoh rezultatet pas njw viti, kur do të përfundojë projekti.

Unë do të doja të shfrytëzoj këtë mundësi për t'i uruar punën të mbarë dhe të suksesshme ministrit Todorov, stafit tw tij dhe kontraktuesit.

Falemnderit pwr vwmendjen tuaj.

